



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), dhe nenet 20 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2016, miratoi si vijon:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj procedurat dhe parimet për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, metodën e llogaritjes së ndryshimeve në vlerën ekonomike të një banke që ndërlihet me ndryshimin e pozicioneve në librin e bankës si rezultat i përdorimit të një stresimi standard të normës së interesit dhe kërkesat për raportim në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo-bankare (në vijim: *Ligji për bankat*), apo siç janë përkufizuar më poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:
  - 1.1. **Rreziku i normës së interesit në librin e bankës** nënkupton rrezikun e normës së interesit që rrjedh nga transaksionet e kryera në pozicionet e librit të bankës.
  - 1.2. **Rreziku i riçimit** nënkupton rrezikun ndaj të cilit banka ekspozohet si rezultat i mospërputhjeve të maturitetit (për normat fikse të interesit) dhe ri-vlerësimit të normave të interesit (për normat e ndryshueshme të interesit) të pozicioneve në librin e bankës.
  - 1.3. **Rreziku i kurbës së kthimit (Yield curve)** nënkupton rrezikun ndaj të cilit një bankë ekspozohet si rezultat i ndryshimit të pjerrtësisë së kurbës së kthimit.

1.4. **Rreziku bazë** nënkupton rrezikun ndaj të cilit një bankë ekspozohet si rezultat i ndryshimeve të normave referencë të interesit për instrumentet me karakteristika të ngjashme për nga maturiteti ose periudha deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.

1.5. **Rreziku i opsioneve** nënkupton rrezikun ndaj të cilit një bankë ekspozohet si rezultat i opsioneve të përfshira në pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit (për shembull kreditë me opion të parapagimit, depozitat me opion të tërheqjes së hershme, etj).

1.6. **Libri i tregtueshëm** nënkupton të gjitha pozicionet në instrumentet financiare dhe mallrat e mbajtura me qëllim tregtimi ose për të mbrojtur pozicionet tjera të librit të tregtueshëm.

1.7. **Libri i bankës** përbëhet nga të gjithë zërat bilancor dhe zërat jashtë-bilancor të një banke, përveç atyre që konsiderohen si pozicione të librit të tregtueshëm.

1.8. **Vlera ekonomike e ekuitetit të një banke** nënkupton llogaritjen e vlerës aktuale të të gjitha rrjedhave neto të pritshme të parasë, të pozicioneve në librin e bankës, si :, rrjedhjet e pritshme të parasë nga mjetet e bankës të zbritura me rrjedhjet e pritshme të parasë nga detyrimet e bankës.

1.9. **Valuta kryesore** nënkupton çdo valutë që përbën më shumë se 5% të totalit të mjeteve ose detyrimeve në librin e bankës.

1.10. **Stresimi standard i normës së interesit** nënkupton zhvendosjen paralele të normës së interesit, pozitive apo negative, në kurbën referencë të kthimit prej 200 pikësh bazë.

1.11. **Pikët bazë** nënkupton njësinë e barabartë me një të njëqindat e 1%.

1.12. **Shuma nocionale e kryegjësë** – Kryegjësja është nocionale atëherë kur nuk është e paguar as e arkëtuar. Kjo vlerë përdoret vetëm për përcaktimin e shumës së interesit dhe tarifave që duhet të këmben për shumën specifike nocionale.

### Neni 3

#### **Mbikëqyrja e rrezikut të normës së interesit nga Bordi dhe Menaxhmenti i Lartë**

1. **Bordi i Drejtorëve** bartë përgjegjësinë përfundimtare për të kuptuar natyrën dhe nivelin e rrezikut të normës së interesit të marrë nga banka, i cili duhet të:

1.1 Të miratojë strategjinë e biznesit dhe politikat që udhëheqin apo ndikojnë në rrezikun e normës së interesit të bankës;

1.2 Të rishikojë objektivat e përgjithshme të bankës, lidhur me rrezikun e normës së interesit dhe të sigurojë udhëzime të qarta lidhur me nivelin e rrezikut të normës së interesit, të pranueshme nga banka;

1.3 Të miratojë politikat të cilat identifikojnë linjat e autoritetit dhe përgjegjësisë për menaxhimin e ekspozimeve të rrezikut të normës së interesit;

- 1.4 Të miratojë politikat e përgjithshme të bankës, lidhur me rrezikun e normës së interesit dhe të sigurojë se menaxhmenti merr hapa të nevojshëm për identifikimin, matjen, monitorimin, dhe kontrollimin e këtyre rreziqeve;
  - 1.5 Të rishikojë kohë pas kohe informatat të cilat janë të detajuara mjaftueshëm dhe në kohë për të kuptuar dhe vlerësuar performancën e menaxhmentit të lartë në monitorimin dhe kontrollin e këtyre rreziqeve, në pajtueshmëri me politikat e miratuara nga bordi i bankës. Shqyrtimet e tilla duhet të kryhen rregullisht dhe më shpesh aty ku banka mban pozicione të rëndësishme në instrumentet komplekse;
  - 1.6 Të rishikojë politikat e rëndësishme për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit si dhe strategjinë e përgjithshme të biznesit e cila afekton ekspozimin e rrezikut të normës së interesit të bankës, së paku në baza vjetore;
  - 1.7 Të inkurajojë diskutimet në mes të anëtarëve të bordit dhe menaxhmentit të lartë, si dhe në mes të menaxhmentit të lartë dhe niveleve tjera në bankë, lidhur me ekspozimet e rrezikut të normave të interesit të bankës dhe procesit të menaxhimit të tij.
2. **Menaxhmenti i lartë** është përgjegjës të sigurojë se banka posedon politikat dhe procedurat adekuate për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit, si afatgjatë po ashtu edhe në baza ditore dhe të sigurojë linja të qarta të autoritetit dhe përgjegjësisë për menaxhimin dhe kontrollin e këtij rreziku.
- 2.1 Menaxhmenti i lartë duhet të kujdeset për mbajtjen e:
    - 2.1.1 Limiteve adekuate për marrjen e rrezikut;
    - 2.1.2 Sistemeve adekuate dhe standardeve për matjen e rrezikut;
    - 2.1.3 Standardeve për vlerësimin e pozicioneve dhe matjen e performancës;
    - 2.1.4 Një sistemi gjithëpërfshirës të raportimit të rrezikut të normës së interesit dhe një proces për rishikimin e menaxhimit të rrezikut të normës së interesit; dhe
    - 2.1.5 Kontrollave të brendshme efektive.
  - 2.2 Raportet e rrezikut të normës së interesit për menaxhmentin e lartë, duhet të ofrojnë informata të agreguara si dhe detaje të mjaftueshme mbështetëse, në mënyrë që menaxhmenti të vlerësojë ndjeshmërinë e institucionit ndaj ndryshimeve në kushtet e tregut dhe faktorëve tjerë të rëndësishëm të rrezikut.
  - 2.3 Menaxhmenti i lartë, së paku një herë në vit, duhet t'i rishikojë politikat dhe procedurat e bankës lidhur me rrezikun e normës së interesit, për të siguruar adekuatshmërinë e tyre.
  - 2.4 Menaxhmenti i lartë duhet të inkurajoj dhe të marrë pjesë në diskutimet me anëtarët e bordit dhe, varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i bankës, me stafin e menaxhimit të rrezikut, lidhur me matjen, raportimin dhe procedurat e menaxhimit të këtij rreziku.
  - 2.5 Menaxhmenti i lartë duhet të sigurojë që analiza dhe menaxhimi i aktiviteteve në lidhje me rrezikun e normës së interesit, kryhet nga stafi kompetent me njohuri teknike dhe me përvojë në përputhje me natyrën dhe fushëveprimin e aktiviteteve të bankës. Duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore me njohuri të thella për të menaxhuar këto aktivitete dhe për të zëvendësuar mungesën e përkohshme të stafit kryesor.

### **3. Linjat e raportimit dhe autoriteti për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit**

- 3.1 Bordi i Drejtorëve duhet qartë të identifikojë individët dhe/ose komitetet përgjegjës/e për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të ndryshme për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit.
- 3.2 Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se ekziston ndarje adekuate e detyrave në procesin e menaxhimit të rrezikut për aktivitetet kryesore, për të evituar konfliktet e mundshme të interesit.
- 3.3 Menaxhmenti i lartë duhet të definojë qartë linjat e autoritetit dhe përgjegjësitë për implementimin e strategjive dhe për matjen e rrezikut, si dhe të qartësoj funksionet e raportimit të procesit për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit.
- 3.4 Menaxhmenti i lartë duhet gjithashtu të ofrojë siguri të arsyeshme se të gjitha aktivitetet dhe të gjitha aspektet e rrezikut të normës së interesit janë përfshirë në procesin e bankës për menaxhimin e rrezikut.
- 3.5 Menaxhmenti i lartë duhet të siguroj se ekzistojnë masa mbrojtëse të mjaftueshme për të minimizuar mundësinë që individët të cilët inicojnë pozicionet e marrjes së rrezikut, mund të ndikojnë në mënyrë jo të përshtatshme në funksionet kyçe të kontrollit të procesit të menaxhimit të rrezikut, të tilla si hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave, raportimi i rreziqeve për menaxhmentin e lartë, dhe kryerja e funksioneve të zyrës mbështetëse (back-office).
- 3.6 Natyra dhe fushëveprimi i këtyre masave duhet të jetë në përputhshmëri me madhësinë dhe strukturën e bankës. Ato, gjithashtu duhet të jenë proporcionale me vëllimin dhe kompleksitetin e rrezikut të normës së interesit të shkaktuar nga banka dhe kompleksiteti i transaksioneve dhe zotimeve të saj.
- 3.7 Personeli i ngarkuar me matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të normës së interesit, duhet të ketë njohuri të mirëfilltë për të gjitha llojet e rrezikut të normës së interesit me të cilat ballafaqohet banka.

#### **Neni 4**

#### **Politikat dhe procedurat adekuate për menaxhimin e rrezikut**

1. Banka duhet të ketë politika dhe procedura të përcaktuara qartë për kufizimin dhe kontrollin e rrezikut të normës së interesit. Këto politika duhet të aplikohen në bazë të konsoliduar, nëse është e nevojshme, edhe në filialet e veçanta ose njësitë tjera të bankës. Politikat dhe procedurat e tilla duhet të përcaktojnë linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies mbi vendimet e marra për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit dhe duhet qartë të përcaktojnë instrumentet e autorizuara, strategjitë mbrojtëse dhe mundësitë e marrjes së pozicioneve. Politikat dhe procedurat e bankës duhet të përmbajnë së paku:
  - 1.1 Politikat e rrezikut të normës së interesit duhet të identifikojnë parametrat kuantitativ të cilët përcaktojnë nivelin e pranueshëm të rrezikut të normës së interesit për bankën.

- 1.2 Limitet duhet të specifikohen më hollësisht për llojet e caktuara të instrumenteve, portfoliove dhe aktiviteteve, sipas nevojës.
  - 1.3 Të gjitha politikat e rrezikut të normave të interesit duhet rishikohen së paku një herë në vit dhe të shqyrtohen sipas nevojës.
  - 1.4 Menaxhmenti i lartë duhet të përcaktojë procedurat specifike dhe miratimet e nevojshme për përjashtimet nga politikat, limitet dhe autorizimet.
2. Banka duhet të identifikojë rreziqet e normave të interesit të ndërlidhura me produktet dhe aktivitetet e reja dhe të sigurohet se këto rreziqe iu nënshtrohen procedurave dhe kontrollave adekuate, para lansimit të tyre. Iniciativat kryesore mbrojtëse apo të menaxhimit të rrezikut duhet të miratohen paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve ose nga një komision adekuat i përzgjedhur nga Bordi i Drejtorëve dhe banka duhet të kujdeset që me rastin e shtimit të aktiviteteve të reja, së paku të aplikoj kërkesat si vijon:
- 2.1 Produktet dhe aktivitetet të cilat janë të reja në bankë, duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi të kujdesshëm para lansimit apo investimit, për të siguruar që banka kupton karakteristikat e rrezikut të normës së interesit të tyre dhe mund të përfshijë ato në procesin e menaxhimit të rrezikut.
  - 2.2 Gjatë analizimit të një produkti apo aktiviteti, nëse paraqet ose jo ndonjë element të ri të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit, banka duhet të jetë e vetëdijshme për ndryshimet në maturitetin e një instrumenti, riçmimit, apo kushtet e ripagimit/shlyerjes të cilat mund t'i afektojnë materialisht karakteristikat e produktit ndaj rrezikut të normës së interesit.
  - 2.3 Para lansimit të një produkti të ri, marrjes së ndonjë pozicioni mbrojtës, ose strategjie të caktuar, menaxhmenti duhet të sigurojë vendosjen e procedurave adekuate operacionale dhe sistemeve të kontrollit të rrezikut .
  - 2.4 Propozimet për të siguruar instrumente të reja apo strategji të reja duhet të përmbajnë këto karakteristika:
    - 2.4.1. Përshkrimin përkatës të produktit apo strategjisë;
    - 2.4.2. Identifikimin e resurseve të nevojshme për të vendosur kontrolla të shëndosha dhe efektive të menaxhimit të rrezikut të normës së interesit të produktit apo aktivitetit të ri;
    - 2.4.3. Një analizë të arsyeshmërisë së aktiviteteve të propozuara lidhur me kushtet e përgjithshme financiare të bankës dhe nivelet e kapitalit; dhe
    - 2.4.5. Procedurat që duhet përdorur për të matur, monitoruar dhe kontrolluar rreziqet e produktit apo aktivitetit të propozuar.

## Neni 5

### Funksionet për matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut

1. Bankat duhet të vendosin sisteme për matjen e rrezikut të normave të interesit që vlerësojnë efektet e ndryshimeve të normave të interesit si në të hyrat e bankës po ashtu edhe në vlerën ekonomike të saj. Këto sisteme duhet të sigurojnë masa kuptimplota për nivelet aktuale të ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të normës së interesit dhe duhet të jenë sisteme adekuate për të identifikuar çdo ekspozim të tepërt që mund të rrjedh nga aktivitetet e bankës.
  - 1.1 Sistemet e matjes duhet:
    - 1.1.1. Të vlerësojnë të gjitha rreziqet materiale të normës së interesit të lidhura me mjetet, detyrimet dhe pozicionet e zërave jashtë bilancor të bankës;
    - 1.1.2. Të përdorin parimet financiare të pranuar dhe teknikat adekuate për matjen e rrezikut; dhe
    - 1.1.3. Të përdorin supozime dhe parametra të dokumentuara mirë.
  - 1.2 Sistemi i një banke për matjen e rrezikut të normës së interesit duhet të adresoj të gjitha burimet materiale të rrezikut të normës së interesit duke përfshirë rrezikun e ricmimit, rrezikun e kurbës së kthimit, rrezikun bazë dhe rrezikun e ekspozimit të opsioneve.
  - 1.3 Instrumentet me karakteristika të opsioneve të përfshira ose eksplicite, duhet të kenë vëmendje të veçantë.
  - 1.4 Gjatë zhvillimit të sistemeve për matjen e rrezikut të normës së interesit, banka duhet të sigurojë që shkalla e hollësive rreth natyrës së pozicioneve të saj të ndjeshme ndaj ndryshimit të normës së interesit, është në përputhje me kompleksitetin dhe rrezikun e bartur në këto pozicione.
2. Banka duhet të vendosë dhe të zbatojë limite operationale dhe praktika tjera të cilat mbajnë ekspozimet brenda niveleve të saj në përputhje me politikat e saj të brendshme, të cilat duhet të përmbushin kriteret si vijon:
  - 2.1 Limitet e një banke duhet të jenë në përputhje me metodën e saj të përgjithshme për matjen e rrezikut të normës së interesit. Limitet e agreguara të rrezikut të normave të interesit që artikulojnë qartë nivelin e rrezikut të pranueshëm të normës së interesit për bankën, duhet të miratohen nga bordi i drejtorëve dhe të ri-shikohen se paku një herë në vit. Limitet e tilla duhet t'i përshtaten madhësisë, kompleksitetit dhe adekuatshmërisë së kapitalit të bankës, si dhe aftësisë së saj për të matur dhe menaxhuar rreziqet e saj.
  - 2.2 Varësisht nga natyra e mjeteve të bankës dhe niveli i kompleksitetit të përgjithshëm të saj, limitet mund të përcaktohen edhe për njësitë individuale të biznesit, portofoliove, llojeve të instrumenteve, apo instrumenteve specifike. Niveli i të dhënave për limitet e rrezikut duhet të reflektojë karakteristikat e mjeteve të bankës, duke përfshirë edhe burimet e ndryshme të rrezikut të normës së interesit ndaj të cilave banka është e ekspozuar.

- 2.3 Menaxhmenti i lartë duhet të njoftohet menjëherë për përjashtimet nga limitet e caktuara. Banka duhet të ketë një politikë të qartë se si menaxhmenti i lartë do të informohet dhe çfarë veprimi duhet të merret nga menaxhmenti në raste të tilla.
- 2.4 Forma e limiteve për adresimin e efektit të ndryshimit të normave në vlerën ekonomike të kapitalit të bankës, duhet t'i përshtatet madhësisë dhe kompleksitetit të pozicioneve të saj.
3. Banka duhet të matë ekspozimin e saj ndaj humbjes në kushtet e stresuara të tregut, duke përfshirë edhe skenarët më të vështira të supozuara dhe të marrin në konsideratë këto rezultate gjatë krijimit dhe ri-shqyrtimit të politikave të saj dhe limiteve të caktuara për rrezikun e normës së interesit. Për këtë qëllim bankat duhet të themelojnë sisteme adekuate dhe performojnë stress-teste të cilat duhet të përmbushin kriteret si vijon:
- 3.1 Sistemi për matjen e rrezikut duhet të mbështetet nga një vlerësim i arsyeshëm i efektit të kushteve të stresuara të tregut për bankën.
- 3.2 Stress-testet duhet të ndërtohen për të siguruar informata për llojet e kushteve nën të cilat strategjitë apo pozicionet e bankës më së shumti mund të jenë të ndjeshme dhe si rezultat i tyre mund të përshtaten për karakteristikat e rrezikut të bankës.
- 3.3 Disa nga skenarët e mundshëm të stress-testeve mund të përfshijnë edhe ndryshime të menjëhershme në nivelin e përgjithshëm të normave të interesit, ndryshimet në raportet në mes të normave kryesore të tregut (p.sh. rreziku bazë), ndryshimet në rrezikun e kthimit të kurbës (p.sh. rreziku i kthimit të kurbës), ndryshimet në likuiditetin e tregjeve kryesore financiare, apo ndryshimet në paqëndrueshmërinë e normave të tregut.
- 3.4 Përveç këtyre, skenarët e stress-testeve duhet të përfshijnë kushtet nën të cilat dështojnë edhe supozimet dhe parametrat kryesore të biznesit. Në veçanti është kritikë përdorimi i stress-testeve me supozime për instrumentet jolikuide dhe instrumentet me maturitet të pasigurt kontraktual, për të kuptuar profilin e rrezikut të bankës. Në kryerjen e stress-testeve, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet instrumenteve apo tregjeve ku ekzistojnë koncentrimet, pasi që pozicionet e tilla mund të jetë më e vështira për tu likuiduar apo të kompenzohen në situata të vështira.
- 3.5 Banka duhet të marrë në konsideratë skenarët e “rastit më të keq” përveç skenarëve që mund të ndodhin. Menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve duhet të rishikojë së paku njëherë në vit, hartimin dhe rezultatet e stress-testeve, si dhe të sigurohen se janë vendosur planet e duhura për parashikimin e rrezikut.
4. Banka duhet të ketë sistem informativ adekuat për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e ekspozimeve të normave të interesit. Raportet duhet të sigurohen me kohë për bordin e drejtorëve të bankës, menaxhmentin e lartë dhe, sipas nevojës, menaxherët individual të degëve të bankës. Raportet që përshkruajnë ekspozimin e rrezikut të normës së interesit të bankës, duhet të shqyrtohen nga bordi në baza të rregullta kohore. Megjithatë llojet e raporteve të cilat përgatiten për bordin dhe për nivelet e ndryshme të menaxhmentit dallojnë, varësisht nga profili i bankës ndaj rrezikut të normës së interesit, këto raporte së paku duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- 4.1 Përmbledhjen e ekspozimeve të agreguara të bankës;
- 4.2 Raportet të cilat dëshmojnë pajtueshmërinë e bankës me politikat dhe limitet e vendosura;
- 4.3 Supozimet kryesore, për shembull, sjellja e depozitave pa-maturitet dhe informatat për parapagimin/shlyerjen;
- 4.4 Rezultatet e stress-testeve, duke përfshirë edhe ato të cilat marrin në konsideratë dështimin e supozimeve dhe parametrave kryesor të bankës; dhe
- 4.5 Përmbledhje e të gjeturave nga rishikimet e politikave dhe procedurave të rrezikut të normës së interesit dhe adekuatshmërisë së sistemeve për matjen e rrezikut të normës së interesit, duke përfshirë këtu edhe gjetjet nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm.

## **Neni 6**

### **Kontrollet e brendshme**

1. Banka duhet të ketë kontrolla të brendshme adekuate për të siguruar integritetin e procesit të tyre për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit sipas kriterëve në vijim:
  - 1.1. Kontrollet e brendshme duhet të jenë pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të bankës.
  - 1.2. Këto kontrolla duhet të promovojnë operacione efektive dhe efikase, raportim të besueshëm financiar dhe rregullator dhe pajtueshmëri me ligjet përkatëse, rregulloret dhe politikat institucionale.
2. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm për rrezikun e normës së interesit duhet të përfshijë:
  - 2.1 Një mjedis të fortë të kontrollit;
  - 2.2 Një proces adekuat për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut;
  - 2.3 Vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, të tilla si politikat, procedurat, dhe metodologjitë;
  - 2.4 Sistemet adekuate për menaxhimin e informatave ; dhe
  - 2.5 Rishikim të vazhdueshëm të politikave, procedurave dhe metodologjive të përcaktuara.

## **Neni 7**

### **Adekuatshmëria e kapitalit**



1. Banka duhet të mbajë kapital në proporcion me nivelin e rrezikut të normës së interesit që ndërmerr.
2. Banka duhet të llogaritë raportin midis vlerës së përgjithshme të peshuar në librin e bankës (diferencën në vlerën ekonomike të librit të bankës) dhe shumës së Kapitalit të Klasit të parë dhe Kapitalit të Klasit të dytë (gjithsej kapitali rregullator).
3. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, nëse raporti është më i lartë se 20%, banka brenda tre ditëve duhet t'i dorëzojë BQK-së draftin e veprimit të ndërmarrë për të zvogëluar këtë raport. BQK mund të pranoj veprimet e propozuara nga banka dhe/apo të përcaktojë masa dhe afate tjera për të zvogëluar raportin e vlerës së përgjithshme të peshuar të pozicioneve në librin e bankës dhe shumës së Kapitalit të Klasit të parë dhe Kapitalit të klasit të dytë (gjithsej kapitali rregullator).

### **Neni 8**

#### **Burimet e rrezikut të normës së interesit**

1. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës, mund të ndikojë negativisht në të ardhurat (të ardhurat neto nga interesi) ose në vlerën ekonomike në librin e bankës. Një bankë duhet të vlerësojë format e ndryshme të rrezikut të normës së interesit ndaj të cilave mund të ekspozohet. Ato përfshijnë:
  - 1.1 rrezikun e riçimit,
  - 1.2 rrezikun e kthimit të kurbës,
  - 1.3 rrezikun bazë, dhe
  - 1.4 rrezikun e opsioneve.

### **Neni 9**

#### **Metodologjia për llogaritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës**

1. Bankat, për qëllimet e llogaritjes së ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, duhet të përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, duke aplikuar një *stresim* standard të normës së interesit në pozicionet e librit të bankës, në të gjitha valutat kryesore individualisht, dhe në valuta të tjera mbi baza të agreguara.
2. Bankat, për qëllime të llogaritjes sipas metodës së vlerësimit të ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës, duhet të shpërndajnë pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit, në 13 intervale kohore, siç përcaktohet në Tabelën 1 të këtij neni.

3. Bankat duhet të shpërndajnë pozicionet me normë interesi fikse në intervale kohore, sipas maturitetit të mbetur dhe pozicionet me normë interesi të ndryshueshme në intervale kohore, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.
4. Bankat duhet të përdorin faktorët e peshimit të rrezikut në Tabelën 1 të këtij Neni, të cilat llogariten si rezultat i shumëzimit të stresimit të normës së interesit prej 200 pikësh bazë me kohëzgjatjen e modifikuar të përlogaritur për çdo interval kohor.
5. Bankat, në rastet kur përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, do të ndjekin hapat e mëposhtëm:
  - 5.1.Mbledhen, për çdo valutë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha valutat tjera mbi baza të agreguara, pozicionet e mjeteve dhe detyrimeve dhe instrumentet financiare derivative (ose mjeteve dhe detyrimeve jashtë-bilancore ), për secilin interval kohor, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto për çdo interval;
  - 5.2.Shumëzohet pozicioni total neto i llogaritur sipas nënparagrafit “5.1” të këtij neni, për çdo interval kohor, me peshat e përcaktuara në tabelën 1 të këtij Neni, për çdo valutë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha valutat tjera mbi baza të agreguara;
  - 5.3.Mbledhen të gjitha pozicionet e peshuara, të llogaritura për të gjitha intervalet kohore, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto në blerje ose në shitje për çdo valutë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha valutat tjera mbi baza të agreguara;
  - 5.4.Mbledhen pozicionet neto në blerje dhe në shitje për të gjitha valutat, me qëllim llogaritjen e pozicionit total neto të peshuar në librin e bankës.
6. Pozicioni total neto i peshuar i librit të bankës, që përcaktohet me nënparagrafin “5.4” të këtij neni, shprehet në shumë absolute dhe do të përfaqësojë ndryshimin në ekspozimin e librit të bankës, si rezultat i aplikimit të *stresimit* standard të normës së interesit.
7. Udhëzimet e hollësishme lidhur me aplikimin e metodologjisë për llogaritjen e ekspozimit të rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, për qëllim të hartimit të formave të raportimit të BQK-së, janë paraqitur në Aneksin 1 të kësaj rregullore.
8. BQK bazuar në kërkesat e kësaj rregulloreje përgatit format e raportimit të cilat ju dërgohen bankave. Plotësimi i formave duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe instruksionet e përgjithshme të përacktuar me shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

**Tabela 1: Peshat sipas zonave kohore**

<b>Intervali kohor</b>	<b>Mesi i intervalit kohor</b>	<b>Kohëzgjatja e modifikuar</b>	<b>Ndryshimi i parashikuar në kthim/përfitim (yield)</b>	<b>Faktori i peshimit</b>
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>Deri ne 1 muaj</b>	<b>0.5 muaj</b>	<b>0.04 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>0.08%</b>
<b>1 deri 3 muaj</b>	<b>2 muaj</b>	<b>0.16 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>0.32%</b>
<b>3 deri 6 muaj</b>	<b>4.5 muaj</b>	<b>0.36 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>0.72%</b>
<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>9 muaj</b>	<b>0.71 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>1.43%</b>
<b>1 deri 2 vite</b>	<b>1.5 vite</b>	<b>1.38 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>2.77%</b>
<b>2 deri 3 vite</b>	<b>2.5 vite</b>	<b>2.25 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>4.49%</b>
<b>3 deri 4 vite</b>	<b>3.5 vite</b>	<b>3.07 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>6.14%</b>
<b>4 deri 5 vite</b>	<b>4.5 vite</b>	<b>3.85 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>7.71%</b>
<b>5 deri 7 vite</b>	<b>6 vite</b>	<b>5.08 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>10.15%</b>
<b>7 deri 10 vite</b>	<b>8.5 vite</b>	<b>6.63 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>13.26%</b>
<b>10 deri 15 vite</b>	<b>12.5 vite</b>	<b>8.92 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>17.84%</b>
<b>15 deri 20 vite</b>	<b>17.5 vite</b>	<b>11.21 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>22.43%</b>
<b>Mbi 20 vite</b>	<b>22.5 vite</b>	<b>13.01 vite</b>	<b>200 bp</b>	<b>26.03%</b>

## **Neni 10**

### **Instrumentet financiare derivative**

Bankat, në rastin kur përdorin instrumentet financiare derivative në librin e bankës, për të menaxhuar rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, duhet të përfshijnë këtë instrument (derivativ financiar) në llogaritjen e raportit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës ndaj kapitalit rregullator.

## **Neni 11**

### **Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës**

1. Banka duhet të përfshijë në raportin e saj mbi ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, të gjitha pozicionet në librin e bankës, të cilat janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në normën e interesit.
2. Banka duhet të raportojë rregullisht, ekspozimet e saj ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, në BQK.
3. Banka duhet të raportojë mbi ekspozimet e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës në baza individuale dhe baza të konsoliduara, valutat kryesore individuale dhe të gjitha valutat tjera në baza të agreguara.
4. Banka duhet të dorëzojë në BQK, format e raportimit të përcaktuara nga BQK, të plotësuar sipas aneksit 1 të kësaj rregullore, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori, së bashku me raportet e rregullta tremujore.

**Neni 12**  
**Dispozitat kalimtare**

Bankat duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj rregulloreje deri me datën 01 janar 2017.

**Neni 13**  
**Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

**Neni 14**  
**Shtojca**

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është shtojca 1.

**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën 2 maj 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci

## Shtojca 1

### INSTRUKSIONE TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtyre instruksioneve është të ofroj udhëzime për bankat në përgatitjen e formularëve të raportimit në BQK, në përputhje me këtë rregullore.
2. Bankat duhet të konvertojnë në Euro, shumën e shprehur në valutë të huaj, duke zbatuar kursin zyrtar të këmbimit në fuqi në datën e raportimit, gjatë plotësimit të formularëve të raportimit.
3. Bankat duhet të përfshijnë, në formularët e raportimit, ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit të përfshira në librin e bankës, të cilat konsiderohen të ndjeshme ndaj ndryshimeve të këtyre normave.
4. Mjetet e ndjeshme ndaj normës së interesit apo detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit – mjetet apo detyrimet të cilave mund t'i ricaktohet çmimi apo të cilat maturojnë brenda një periudhe të caktuar kohore.
5. Mjetet, detyrimet dhe zërat jashtë bilancor të ndjeshme ndaj normës së interesit, janë ato pozicione të cilat bartin normë interesi si dhe pozicionet të cilat nuk bartin normë interesi por që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit p.sh. instrumentet financiare të shitura me diskontim të tilla si obligacionet me kupon zero.
6. Mjetet, detyrimet dhe zërat jashtë bilancor jo-të ndjeshme ndaj normës së interesit, duhet të raportohen në kolonën “Mjetet jo të ndjeshme ndaj normës së interesit”.
7. Pozicionet e zërave të bilancit të ndjeshme ndaj normës së interesit duhet të raportohen në baza neto (pas zbritjes së rezervave të alokuara) dhe të korrigjuara për shumën e premive, diskonteve dhe ndryshimeve në vlerën fer.
8. Bankat nuk i konsiderojnë si të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normës së interesit, zërat e bilancit të tilla si: paratë e gatshme, mjetet fikse, kapitali i aksionar dhe zëra tjerë të ngjashëm, si dhe zërat jashtë bilancor të tillë si: garancionet bankare, letër-kreditë, kambialet, linjat kreditore dhe zërat e tjerë standard jashtë bilancit nuk duhet të konsiderohen si pozicione të ndjeshme ndaj normës së interesit.
9. Pozicionet e zërave të bilancit të bankës duhet të shpërndahen në periudha të maturitetit duke u bazuar në parimet e mëposhtme:
10. Të gjitha mjetet dhe detyrimet që i takojnë librit të bankës dhe të gjitha pozicionet e zërave jashtë-bilancor që i takojnë librit të bankës, të cilat janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normës së interesit (duke përfshirë të gjitha instrumentet derivative të

normës së interesit) shpërndahen në shkallët e maturitetit, që përbehen nga 13 intervale kohore të përcaktuara në Tabelën 1 të kësaj rregullore.

11. Shkallët e maturitetit duhet të përdoren veçmas për çdo valutë e cila përbën më shumë se 5%, qoftë të mjeteve apo të detyrimeve në librin e bankës.
12. Zërat jashtë-bilancor duhet të raportohen në shumën nocionale të kryegjësë për secilën kontratë të zërave jashtë-bilancor.
13. Zërat bilancor trajtohen sipas vlerës në librin e bankës.
14. Të gjithë zërat bilancor të mjeteve dhe detyrimeve që bartin interes, duhet të klasifikohen në zëra me normë fikse të interesit dhe/ose me normë të ndryshueshme interesit.
15. Zërat me normë fikse të interesit janë mjetet dhe detyrimet me normë fikse të interesit, deri në maturitetin e tyre.
16. Zërat me normë të ndryshueshme nënkupton mjetet, detyrimet dhe zërat jashtëbilancor ku norma e tyre e interesit mund të ndryshojë. Zërat e tillë mund të kategorizohen në 2 lloje, siç janë:
17. Zërat me normë interesit të ndryshueshme, janë zërat të cilët në mënyrë automatike do të rivlerësohen në datën e ardhshme të caktuar të riçmimit/rivlerësimit, sipas lëvizjes së indekseve refereruese “normat e përdorura si referencë” përkatëse (të tilla si EURIBOR apo LIBOR) dhe do të përfshijnë ata zëra për të cilët norma e interesit mund të ndryshojë në diskrecion të palës së kundërt.
18. Zërat me normë të administruar janë ata zëra me normë të ndryshueshme të interesit, për të cilët nuk ka datë të caktuar fikse të riçmimit dhe normat e interesit mund të ndryshohen në çdo kohë, në diskrecion të bankës. Mjetet dhe detyrimet të cilat nuk kanë intervale kohore të caktuara të riçmimit (p.sh. llogaritë e depozitave apo të kursimeve) apo maturitet aktual i cili mund të ndryshojë nga maturiteti kontraktual (p.sh. kreditë hipotekare me mundësi të parapagimit) shpërndahen në intervale kohore të riçmimit sipas gjykimit dhe përvojës paraprake të bankës.
19. Analizat ekonometrike apo statistike mund të përdoren për të analizuar sjelljen e pozicioneve të bankës, duke marrë në konsideratë lëvizjet e normave të interesit në të kaluarën.
20. Kriteret minimale për përdorimin e sjelljes bazuar në përvojën historike për nevojat e raportimit të rrezikut të normës së interesit janë si në vijim:
  - a) Supozimet e institucionit duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje për çdo skenar të normës së interesit;
  - b) Banka duhet të shmangë supozimet që janë arbitrare dhe të pa verifikuara nga përvoja dhe performanca e kaluar;
  - c) Bankat mund të përdorin modelet statistike të parapagimit;
  - d) Bankat mund të shfrytëzojnë informatat e brendshme nga njësitë biznesore dhe menaxheriale që mund të ndikojnë në sjelljet e rrjedhave të ardhshme të parasë të pozicioneve me maturitet të padefinuar;

- e) Të dhënat historike që përdoren në modelet statistikore duhet të përfshijnë një periudhë së paku një vjeçare;
- f) Supozimet e realizuara në modele duhet të jenë të dokumentuara.

21. Lidhur me mjetet dhe detyrimet që bartin norma të interesit, data më e hershme e riçimit të interesit nënkupton:

a) Për zërat e mjeteve dhe detyrimeve me normë fikse të interesit, duhet të konsiderohet data e maturitetit të tyre;

b) Për zërat e mjeteve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme të interesit, duhet të konsiderohet data e ardhshme e riçimit të tyre. Në rastet e mjeteve dhe detyrimeve për të cilat normat e interesit mund të ndryshojnë në diskrecion të palës së kundërt, data më e hershme e riçimit merret duke u bazuar në përvojën e kaluar, sipas së cilës riçimi i normës së interesit do të bëhet duke supozuar se norma referencë në të cilën është bazuar norma e interesit ndryshohet menjëherë në ditën tjetër të punës, pas datës së raportimit; dhe

c) Për zërat e mjeteve dhe detyrimeve me normë të administruar të interesit, data më e hershme në të cilën do të ishte e mundur që norma e interesit të mjeteve dhe detyrimeve të ndryshohet, duke supozuar se normat referencë (p.sh. norma primare ose norma standard e kursimeve) në të cilën bazohet norma e interesit, ndryshohet menjëherë në ditën tjetër të punës, pas datës së raportimit.

22. Mjetet dhe detyrimet të cilat mund të paguhën me këste, ose me një pagesë të vetme (*lump sum*) në maturitet, duhet të ndahen në pjesë individuale dhe të shpërndahen në intervale kohore adekuate sipas datës së riçimit për secilën pjesë. Shembulli 1. Një kredi me normë fikse të interesit në shumë prej 100 mijë euro e cila shumë mund të shlyhet me dy këste vjetore nga 50 mijë euro për secilin këst, atëherë duhet të trajtohet si dy kredi, njëra që shlyhet pas gjashtë muaj dhe tjetra pas një viti, dhe të vendosen në intervale kohore adekuate sipas maturitetit të tyre të mbetur. Shembulli 2. Në rastet e kredive me normë interesi të ndryshueshme në shumë prej 100 mijë euro e cila shumë paguhet me dy këste gjashtëmujore, në shumë prej 50 mijë euro për secilin këst, atëherë duhet të trajtohet si dy kredi të ndara dhe të vendosen në intervale kohore adekuate sipas datës së ardhshme të riçimit për secilën pjesë.

23. Bankat duhet të vendosin instrumentet derivative sipas intervaleve kohore përkatëse të instrumenteve, në bazë të të cilave janë lëshuar këto instrumente derivate.

24. Shuma minimale e rezervave të detyrueshme të likuiditetit duhet të vendoset brenda intervalit kohor deri në një muaj, nëse është e ndjeshme ndaj ndryshimit të normave të interesit.

25. Bankat mund të shpërndajnë mjetet e vendosura në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në intervale kohore adekuate, duke marrë në konsideratë përvojën e kaluar të sjelljes apo mund t'i shpërndajnë këto mjete sipas kriterëve në vijim:

- a) 25% e shumës totale të mjeteve në llogaritë rrjedhëse dhe depozitave pa afat duhet të vendoset në pjesën si jo sensitive ndaj normave të interesit;
- b) 75% e shumës totale të mjeteve në llogaritë rrjedhëse dhe depozitave pa afat duhet të shpërndahen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve në intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” deri në intervalin “4-5 vjet”.
- c) Sqarim me shembullin si vijon:

Në intervalin kohor “deri në 1 muaj” do të paraqitet 1/60 e shumës totale të mjeteve në llogaritë rrjedhëse dhe depozitave pa afat sipas pikës b) dhe në intervalin kohor “6 deri në 12 muaj” 6/60 e saj

Supozojmë se banka ka 100 Euro në llogaritë rrjedhëse dhe depozita pa afat:

25 euro vendosen tek kolona jo e ndjeshme ndaj normave të interesit.

75 euro x 1/60 = 1.25 euro deri në 1 muaj

75 euro x 6/60 = 7.5 euro. Në 6 deri 12 muaj, e kështu me radhë.

Më detajisht:

	Muaj	Eur	Eur
Deri në 1 muaj	1/60	75	1.25
1 deri 3 muaj	2/60	75	2.5
3 deri 6 muaj	3/60	75	3.75
6 deri 12 muaj	6/60	75	7.5
1 deri 2 muaj	12/60	75	15
2 deri 3 muaj	12/60	75	15
3 deri 4 muaj	12/60	75	15
4 deri 5 muaj	12/60	75	15

- 26. Ekspozimet jo-performuese (p.sh. kreditë në vonesë më shumë se 90 ditë) nuk duhet të konsiderohen si pozicione të ndjeshme ndaj interesit dhe nuk duhet të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të ekspozimit të rrezikut ndaj normës së interesit në librin e bankës.
- 27. Mjetet dhe detyrimet që nuk kanë interes të tilla si obligacionet me kupon zero duhet të shpërndahen në intervale kohore sipas afatit të mbetur deri në maturim.